



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eco Logic" L.L.C. të datës 15.07.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Invertarizimi i kurorave dhe sipërfaqeve të gjelbërta" me nr. të prokurimit 616-24-6720-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eco Logic" L.L.C. të datës 15.07.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Invertarizimi i kurorave dhe sipërfaqeve të gjelbërta" me nr. të prokurimit 616-24-6720-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Eco Logic" L.L.C. (tutje "parashtruesi") me datë 15.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Invertarizimi i kurorave dhe sipërfaqeve të gjelbërta" me nr. të prokurimit 616-24-6720-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1 - "Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përkatësisht tek neni 9.1 dhe 9.2, është kërkuar: "Arkitekt I peisazhit (niveli shkollimit master). Minimum 5 vite eksperience pune a. Eksperience pune ne dizajnim te parqeve dhe menaxhim te hapësirave te gjelberta, njohuri ne bimesi." Kërkesa e lartcekur për inxh. e aritekturës është diskriminuese sepse ne kemi hulumtuar ne Universitetin e Prishtinës përkatësisht në Fakultetin e Arkitekturës, ku ky i fundit në programin e studimit Arkitekture kombinon grup-lëndësh themelore të përgjithshme (matematikore-natyrore-humane), lëndë themelore profesionale (sipas profileve: konstruksione, projektim, urbanizëm, histori/teori arkitekturale, vizualizim), por nuk ekziston një drejtim specific si Arkitekt Peisazhi të cilën e keni kërkuar ju?!".

P.2. - "Po ashtu, tek kushtet e pjesëmarrjes, ju si AK gjithashtu keni kërkuar: "Dendrolog ose te ngjajshem (niveli shkollimit master). Minimum 5 vite eksperience pune a. Me eksperience ne njohjen dhe identifikimin e llojeve te bimeve" Pas hulumtimit rreth degëve studimore që mundëson Universiteti i Prishtinës dhe në konsultimit me KRPP-në, vërtetua se një drejtim i tillë studiues nuk gjendet në Kosovë, por ka lami të përafërta në Fakultetin e Shencave Natyrore, departamenti i Biologjisë, degët të cilat gjenden në këtë departament dhe janë të ngjajshme me lamin e dendrologjisë. Pra duke u bazuar në të lartcekura kuptohet qartë se kërkesat e lartcekura janë diskriminuese/favorizuese, për shkak se AK-ja qysh në fillim po ju pamundëson ofertimin në këtë aktivitet të prokurimit kompanive me shumë përvojë në këtë fushë, ndërsa po i favorizon hapur disa OE të caktuar".

Pas analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruesit lidhur me kërkesat e DT për arkitekt të peisazhit ose dendrolog është gjetur se këto profesione nuk janë kompatible me programet e akredituara për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të ndryshohen/plotësohen në dosjen e tenderit në të kundërtën kjo mund të përbëj shkelje të nenit 7 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 17.07.2024**

**Visar SHEHU**  
  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net